



BASHKIA
TIRANË

AGJENCIA E RINISË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “ÇELËSI” shpk

Adresa: Tiranë Rruga Kavajës, Pallati Condor, Kati 3

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim **“Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e objekteve specifike WEB, Aplikacioni, Platforma e Kartës së Studentit, si dhe shërbimi i hostimit të tyre”**.

Referenca e procedures: Nr.reference REF-70724-09-04-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e objekteve specifike WEB, Aplikacioni, Platforma e Kartës së Studentit, si dhe shërbimi i hostimit të tyre”.

Fondi limit: 5.760.000 (pesë milion e shtatëqind e gjashtëdhjet mijë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion me anë të VKB-së Nr.157, datë 26.12.2019, për “Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2020–2022 dhe detajimin e buxhetit të Agjencisë së Rinisë për vitin 2020”.

Afati i kryerjes së shërbimit: Mirëmbajtjen e objekteve specifike WEB, Aplikacioni, Platforma e Kartës së Studentit, si dhe shërbimi i hostimit të tyre, do të kryhet për një periudhë kohore 24 (muaj) nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 18.09.2020 ora 10.00

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 70 datë 14 Shtator 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “KREATX” shpk

NUIS L12121023B

Vlera e ofertës – 4.800.000 (katër milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “ÇELËSI” shpk

NUIS J72424001W

Vlera e ofertës – 5.500.000 (pesë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

Arsyet e s’kualifikimit:

1. Operatori ekonomik “Kreatx” shpk nuk ka paraqitur deklaratën mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme.

Vlera e ofertës pa TVSH– 4.800.000 leke pa tvsh (katër milion e tetëqind mijë) lekë

Vlera e ofertës me TVSH – 5.760.000 (pesë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Operatori ekonomik “Kreatx” shpk nuk ka paraqitur deklaratën mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme . Referuar shtojcës Nr.4 të dokumentave standarte të tenderit “Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme” *Operatori ekonomik ka detyrimin të deklarojë Personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakët, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.* Ky parashikim ligjor do të shmang çdo mundësi që operatorët ekonomike që kanë, ose kanë pasur një dënim penal si persona juridikë, apo të përfaqësuar nga individë të dënuar penalisht, të fitojnë kontrata publike.

Në zbatim të ndryshimeve të miratuara në këtë nen, operatorët ekonomike ofertues do të vazhdojnë të paraqesin në formë vetëdeklarimi, sipas shtojcës përkatëse të dokumentave standarde të tenderit, gjendjen e subjektit të tyre. Pra, operatori ekonomik do të deklarojë nëse është apo ka qënë i dënuar për vepra penale, të parashikuara në nenin 45/1 të LPP.

Ndërkohë përvec sa më sipër, operatori ekonomik do të deklarojë edhe mbi gjendjen gjyqësore të anëtarit të organit administrativ, drejtuesit, mbikëqyrësit, aksionerit, ortakut apo për çdo person që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij, se nuk janë ose kanë qënë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

Pikërisht, për të pasqyruar këtë lloj vetëdeklarimi është ndryshuar edhe shtojca përkatëse e dokumentave standarde të tenderit për punë/mallra/shërbime, "Deklaratë mbi Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme". Pra, për efekt pjesëmarrje në tender dhe plotësimin e parashikimeve të nenit 45/1 te LPP, operatorët ekonomikë do të paraqesin vetëdeklarimin e tyre sipas shtojcës përkatëse të dokumentave standarde të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Kreatx” shpk konstatoi se kjo deklaratë nuk është paraqitur nga operatori ekonomik sa më sipër cituar.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson*

një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.....

Operatori ekonomik KREATX nuk ka paraqitur deklaratën për përmbushjen e specifikimeve teknike duke rënë në kundërshtim me pikën 2.1 gërma (ç) e kriterëve të veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.

Operatori ekonomik KREATX nuk ka paraqitur *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1* duke rënë në kundërshtim me pikën 2.1 gërma (c) e kriterëve të veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.

Operatori ekonomik KREATX nuk ka paraqitur *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;* duke rënë në kundërshtim me pikën 2.1 gërma (d) e kriterëve të veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcakohet se: *“Autoriteti Kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “ÇELËSI” shpk me adresë: Tirane Tirane TIRANE Rruga Kavajes, Pallati Condor, Kati 3 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 5.500.000 (pesë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Agjencia e Rinisë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 22.09.2020.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”(i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Agjencia e Rinisë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.